



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.1553/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditësit F.M. BI me seli në Obrancë Komuna e Podujevës me numër biznesit 71203646 të cilin sipas autorizimit e përfaqëson R.H. avokat nga Prishtina kundër të paditurit Qeveria e Kosovës-Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësië (MBPZHR-AZHB) në Prishtinë, me bazë juridike, anulimi i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditurës, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.92/23 i datës 19.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.02.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditurës Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (MBPZHR-AZHB) në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje administrative, KA.nr.92/23 i datës 19.06.2023, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar, është vendosur si në vijim: I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.M. B.I., Anulohet Vendimi 07/4/691 datës 08.04.2016 dhe Letër informimi nr.protok.5909 datës 23.12.2015 të nxjerra nga i padituri Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Prishtinë-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, II. Obligohet i padituri Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (MBPZHR-AZHB) në Prishtinë, që paditësit F.M. B.I. në emër të ëprkrahjes publike sipas kontratës për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural nr.361/2015, ti paguaj shumën shtesë prej 8,786.07€ me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë datë 05.05.2016 e deri në përmbushjen përfundimtare, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, III Refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit përtej shumës së gjykuar në pikën II të dispozitivit dhe atë për shumën shtesë prej 4,958.70€, IV. Ky aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues, V. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesja e paditues Avokatura Shtetërore, ka ushtruar ankesë, me të cilën e kundërshton ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të; shkeljeve të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e paditues, të Priset aktgjykimi i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje administrative, KA.nr.92/23 i datës 19.06.2023, Mbeten në fuqi vendimet e paditues.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, nenit 49 të LKA-së, në drejtim të thënies në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës vlerëson se;

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (MBPZHR-AZHB) në Prishtinë, me vendimin nr.07/4/691 i datës 08.04.2016 ka Refuzuar ankesën e fermerit F.M. nga fshati Obrancë Komuna e Podujevës, si të pa bazuar.

Kundër këtij vendimi administrativ përfundimtar të nxjerr nga organi administrativ, paditësi me padi inicon konflikt administrativ në procedurë gjyqësore, ndërsa Dhoma e shkallës së parë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 12.06.2023, të mbajtur në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës bie Aktgjykimin e ankimuar me të cilin e Aprovon pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Në arsyetim ndër të tjera dhoma e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit kontestues të paditues, është referuar në nenin 5 par.3 të Udhëzimit Administrativ 01/2015 për Masat dhe Kriteret e Perkrahes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural, duke vlerësuar se kriteri i përcaktuar në këtë udhëzues për mos përfshirjen e taksave doganore dhe tatimeve në financim ka të bëjë vetëm në rastet kur përfituesi i subvencionimit, bën import të produktit nga jashtë, ndërsa në rastin konkret përfituesi i subvencionimit, këtu paditësi, nuk ka realizuar importin e produktit traktor 35kw, por importin e ka bërë kompania NTP Kos Comerc, e cila ka paguar taksat doganore dhe tatimet, ndërsa paditësi ka bërë blerje vendore nga kjo kompani. Prandaj gjykata gjeti se i padituri i ka njohur vlerën e investimit në shumën prej 13,185.23€ për qfarë ka autorizuar 75% të pagesës për këtë produkt në vlerë prej 8,888.92€ ndërsa nuk i ka njohur diferencën e investimit sipas faturës në shumën prej 11,714.77€ për qfarë ka rezultuar në autorizim më të vogël të pagesës prej 75% apo shumën prej 8,786.07€, andaj gjykata vlerëson se për shkak se i padituri i ka zbritur vlerën e investimit për traktor shumën prej 11,714.77€, paditësi është dëmtuar në pagesën e financimit prej 75% të kësaj vlere të investuar përkatësisht në shumë prej 8,786.70€. Gjykata vendosi si në pikën II dhe IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 46 par.4 dhe 5 të LKA-së, duke obliguar të padituren që ti paguaj paditësit shumën prej 8,786.07€ me kamatë vjetore prej 8%, dhe në pikën III të dispozitivit duke Refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e dëmit në shumë prej 4,958.70€

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale, këtë qëndrim juridik të dhomës së shkallës së parë, e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me zbatim të gabuar të dispozitave ligjore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK). Dhoma e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, aktgjykimin e ka mbështetur në dispozitat e nenit 5 paragrafi 3 të UA 01.2015.

Dhoma e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me shkeljet ligjore që ka zbatuar e paditura me rastin e vendimmarrjes në procedurën administrative, e të cilat shkelje kanë ndikuar që vendimi kontestues i të paditurës me të drejt të anulohet pjesërisht si i kundërligjshëm.

Në rastin konkret e paditura vendimin e mbështet në Raportin e kontrollit dt.19.12.2015 duke vërtetuar gabimisht gjendjen faktike sa i përket mungesës së informacionit nga çmimorja e AZHB-së, për traktor 35kw, e cila si bazë ka përdor Dokumentin Unik Doganor, përderisa gjendja e vërtet faktike rezulton se kjo deklaratë doganore R-30388/15.12.2015 në shumë prej 13,185.23€ të cilën e ka njohur i padituri në vlerën e investimit 75%, nuk ka të bëjë me paditësin por me një subjekt tjetër importues NTP Kos Commerce.

Paditësi ka paraqit para gjykatës si provë faturën 04/12-15 dt.01.12.2015 me vlerë 24,900.00€, si dëshmi për blerjen e këtij malli nga subjekti NTSH Kos-Commerce, që në fakt paraqet një gjendje tjetër faktike sa i përket vlerësimit të paditurit me rastin e pranimin të investimeve prej 75% të këtij produkti sipas Kontratës për Financimin e Projekteve Investuese të Zhvillimit Rural nr.361/2015,

Dispozita e nenit 5 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ 01/2015 për masat dhe kriteret e përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2015, parasheh:

Shpenzimet e pranueshme janë të kufizuara në ato që janë futur në Listën e Investimeve të pranueshme për masën 101 të paraqitura në Udhëzuesin për Aplikues;

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë me të drejt ka zbatuar të drejtën materiale kur ka dhënë shpjegimet ligjore nga Udhëzuesi për Aplikues për programin për bujqësi dhe zhvillim rural 2015 (masa 101) se në këtë rast kriteri i përcaktuar në këtë Udhëzues për mos përfshirjen e taksave doganore dhe tatimeve në financim nuk ka të bëjë me përfituesin e subvencionimit në këtë rast paditësin, por importin e produktit traktor 35kw, e ka realizuar subjekti NTP Kos Commerce, ndërsa paditësi ka bërë blerje të këtij produkti nga kjo kompani importuese, prandaj Kolegji vlerësoi se dhoma e shkallës së parë me të drejt ka vërtetuar këtë gjendje faktike të dokumentuar me argumente, dhe ka obliguar të paditurën që paditësit t,ia paguaj shumën

shtesë në emër të përkrahjes publike të Kontratës për financimin e projekteve investuese te zhvillimit rural nr.361/2015.

Sa i përket pretendimeve ankimore se dhoma e shkallës së parë nuk ka marrë në konsideratë realitetin e faturës për blerjen e produktit e cila ka kushtuar në shumën prej 13,185.23€, Kolegji vlerësoi se këto pretendime nuk janë të bazuara dhe të argumentuara për të nxjerr një konstatim tjetër faktik apo ligjor, dhe e paditura nuk ka arrit ta kontestoj këtë shitblerje të produktit-traktorit 35kw nga shitësi-importuesi NTP Kos Commerce, si pranim të shpenzimeve të përfshira në projektin investues të paditurit. Gjithashtu Kolegji vlerësoi se nuk gjejnë mbështetje ligjore pretendimet ankimore që kamata prej 8% të llogaritet nga data 12.04.2022 kur i padituri ka dhënë aktvendimin për përgjigje në padi.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase është nuk cënuar ligji në dëm të paditues, thëniet e ankesës ky Kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga dhoma e shkallës së parë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, gjeti se dhoma e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lidhur me nenin 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1553/2023 datë 22.02.2024

Kryetari i kolegjit-gjyqtari

Krenar Berisha